VITI MBARËKOMBËTAR I GJERGJ KASTRIOTIT SKENDERBEUT - 2018

KUVENDI
NR 1315 DATE 12.04.18

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI**

**GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE**

Nr. ____ Prot. Tiranë, më ___/___/2018

**Lënda:** Kërkesë për marrjen e masës disiplinore më të rëndë, sipas nenit 65 të Rregullores

**Drejtuar:** **ZOTIT GRAMOZ RUÇI**

**KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË**

**Këtu**

**Baza Ligjore**: Rregullorja e Kuvendit, nenet 62 – 65.

I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Ne, një grup deputetësh të Kuvendit të Shqipërisë, anëtarë të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, të shqetësuar për ngarjet e rënda dhe të përsëritura që ndodhën në seancën plenare të Kuvendit të datës 12.04.2018, nga skenari i orkestruar i deputetëve të opozitës parlamentare dhe në mënyrë të veçantë i disa deputetëve të grupeve parlamentare të Partisë Demokratike dhe të Lëvizjes Socialiste për Integrim, të cilët kryen shkeljen flagrante të Rregullores së Kuvendit dhe të Kodit të Sjelljes së Deputetëve, si dhe penguan zhvillimin normal të seancës plenare sipas rendit të ditës të përcaktuar në përputhje me Rregulloren.

Deputetët e opozitës të përmenduar në këtë kërkesë, kryen shkeljet e Rregullores së Kuvendit, sipas neneve 62, 64 dhe 65 dhe rreptësisht të ndaluara të Kodit të Sjelljes së Deputetëve, neni 6 i tij, si më poshtë:

- përdorën një gjuhë fyese dhe joparlamentare, si dhe u sollën në mënyrë të padenjë për funksionin e përfaqësuesit të popullit;

[shqiptarja.com]

- penguan zhvillimin normal të seancës dhe ndërmorën sulme fizike ndaj Kryeministrit dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave;
- shkaktuan rrëmujë gjatë zhvillimit të seancës;
- hodhën sende të palejueshme (si miell, shishe uji, vezë, mikrofonin e foltores);
- dëmtuan pajisjet elektronike në sallën e seancës plenare (shkulën mikrofonin e foltores dhe shkulën monitorin e sallës).

Më poshtë ju paraqesim konkretisht shkeljet e rënda të kryera nga këta deputetë, të cilat janë të provuara edhe në filmimet bashkangjitur kësaj kërkese:

**Deputeti Edi Paloka** shkuli monitorin dhe goditi Shërbimin e Sigurisë së Seancës Plenare, si dhe përdori fjalë fyese ndaj Kryeministrit. Deputeti Paloka, ka shpërdoruar detyrën e zëvendëskryetarit të Kuvendit, i cili në respekt të Rregullores dhe Kodit të Sjelljes së Deputetëve duhet të ishte shembull për deputetët e opozitës dhe jo të ushtronte dhunë për shkatërrimin e pajisjeve elektronike që përdoren për mbarëvajten e punimeve në seancë plenare.

**Deputeti Ervin Salijanji** ka përdorur fjalë fyese ndaj Kryeministrit, anëtarëve të Këshillit të Ministrave dhe Drejtuesit të Seancës. Gjithashtu deputeti Ervin Salijanji ka hedhur në drejtim të Kryeministrit dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave sende të forta.

**Deputeti Flamur Noka** ka futur në mënyrë të fshehtë në sallën e seancave plenare qese me miell dhë duke i hedhur ne drejtim të Kryeministrit, anëtarëve të Këshillit të Ministrave dhe Drejtuesit të Seancës; ka përdorur fjalë fyese ndaj Kryeministrië; ka goditur dhe shtyrë punonjësit e shërbimit të Sigurisë të Seancës Plenare, të ngarkuar me detyrën e ruajtjes së rendit dhe qetësisë brenda mjediseve ku zhvillohen seancat pleanare të Kuvendit;

**Deputeti Klevis Balliu** ka futur në mënyrë të fshehtë në sallën e seancave plenare qese me miell dhe i ka hedhur në drejtim të Kryeministrit, anëtarëve të Këshillit të Ministrave dhe Drejtuesit të Seancës; ka përdorur fjalë fyese ndaj Kryeministrit. Gjithashtu, në shkelje të Rregullores ka hedhur disa herë në drejtim të Kryeministrit sende të forta. ( shishe uji , veze)

**Deputeti Endrit Brahimllari** ka përdorur fjalë fyese ndaj Kryeministrit.
Në shkelje të rregullores ka hedhur në drejtim të Kryeministrit dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave shishe me ujë.

**Deputetja Kejdi Mehmetaj** ka përdorur fjalë fyese ndaj Kryeministrit.
Në shkelje të rregullores ka hedhur në drejtim të Kryeministrit dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave shishe me ujë.

Bazuar në nenin 65, pika 2 të Rregullores së Kuvendit, e paraqesim këtë kërkesë, me qëllim që Byroja e Kuvendit të mblidhet për vlerësimin e masës së propozuar prej nesh të parashikuar në nenin 63, shkronja "ç" të Rregullores **"përjashtim nga pjesmarrja në komisione dhe në seancë plenare deri në 10 ditë"** për deputetët e mësipërm.

Shqiptarja.com

[Shqiptarja.com]